



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 147, Datë 19.07.2024

MBI

**DHËNIEN E GARANCISË SË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA HEC “DRAGOBIA” DHE HEC “CEREM” TË SHOQËRISË
“DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 7 të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar nga bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, e ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 255/8 prot, datë 18.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për dhënie e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC “Dragobia” dhe HEC “Cerem”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 17, datë 16.02.2026, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Cerem”, me kapaciteti 8.6 MW dhe HEC-i “Dragobia”, me kapacitet 13.3 MW, me kapacitet total 21.9 MW.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2451 prot, datë 30.11.2023, shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për pajisjen me Garancinë e Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-i “Dragobia” dhe HEC-i “Cerem”.
- Pas zhvillimit të korrespondencës përkatëse me shoqërinë në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të munguar dhe për sa i përket sasisë e energjisë elektrike për të cilën shoqëria nuk ka përfituar asnjë lloj tjetër mbështetjeje, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për lëshimin, transferimin dhe anulimin e

garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, e ndryshuar.

- Duke iu referuar përcaktimeve të nenit 22, pika 6 të ligjit nr. 24/2023, ERE me shkresën nr. 255/2 prot., datë 21.02.2024, i është drejtuar OST sh.a. me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga këto hidrocentrale gjatë kësaj periudhe, kodin/numrin e matësve dhe leximin e datës 1 të secilit muaj të kësaj periudhe për secilin hidrocentral.
- Po ashtu, ERE i është drejtuar dhe “FTL” sh.a. me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike të blerë nga secili hidrocentral i shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., për secilin muaj të periudhës 01.11.2022-30.11.2023, referuar kjo kontratës përkatëse të shitblerjes së energjisë elektrike të nënshkruar me këtë subjekt dhe akt-rakordimeve përkatëse.
- Në përgjigje, OST sh.a. ka sqaruar se, referuar marrëveshjes së lidhjes, për të dy HEC-et si pikë lidhje është pika ku objekti lidhet me rrjetin e Transmetimit dhe pikë matje është pika ku matet energjia elektrike që HEC-et “Dragobia” dhe “Cerem” injektojnë në Rrjetin e Transmetimit.
- Ndërsa “FTL” sh.a. ka sqaruar se shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. është e lidhur në rrjetin e transmetimit në nivel tensioni 110 kV dhe ka një pikë ku matet energjia për HEC-et “Dragobia” dhe “Cerem”, ndaj “OST” sh.a. i përcjell shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. vetëm një të dhënë për prodhimin e (dy) centraleve prodhuese sipas pikës së matjes, si dhe ka paraqitur energjinë e blerës nga ana e saj gjatë periudhës së kërkuar.
- Për gjithë sa depozituar, vlerësohet që shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. t’i lëshohet GO për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et “Dragobia” dhe “Cerem”, për periudhën 01.11.2022-30.10.2023, sipas të dhënave të OST sh.a., duke i zbritur kësaj sasive energjinë e blerë nga “FTL” sh.a.
- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 22, pika 5 të ligjit nr. 24/2023, *Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e Garancisë së Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet “Dragobia” dhe “Cerem” të shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., për periudhën 01.11.2022-30.10.2023, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

Periudha	Energjia prodhuar (MWh) nga HEC-et “Dragobia” dhe “Cerem” për të cilën lëshohet Garanci Origjine
<i>Nëntor 2022</i>	167
<i>Dhjetor 2022</i>	72
<i>Janar 2023</i>	62
<i>Shkurt 2023</i>	60
<i>Mars 2023</i>	86
<i>Prill 2023</i>	103
<i>Maj 2023</i>	62
<i>Qershor 2023</i>	153
<i>Korrik 2023</i>	89
<i>Gusht 2023</i>	59
<i>Shtator 2023</i>	34
<i>Tetor 2023</i>	0
Totali	947